

DDB Albania Sh.A.

**Pasqyrat financiare individuale
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011
(dhe raporti i audituesve të pavarur)**

Përmbajtja

Raporti i audituesve të pavarur	i-ii
Pasqyra individuale e pozicionit financiar	1
Pasqyra individuale e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor	2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra individuale e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor	4
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale	5
1 Informacion i përgjithshëm	5
2 Baza e përgatitjes	5
3 Përmbledhje e politikave kontabël	6
4 Përcaktimi i vlerës së drejtë	11
5 Menaxhimi i riskut financiar	11
6 Aktive afatgjata jo-materiale	15
7 Aktive afatgjata materiale	16
8 Investime në filiale	16
9 Kërkesa për arkëtim nga nga debitorët	17
10 Mjete monetare dhe ekuivalente me to	17
11 Kapitali themeltar	17
12 Furnitorë dhe detyrime të tjera	17
13 Të ardhurat	18
14 Kosto për kryerjen e shërbimeve	18
15 Shpenzime lidhur me përfitimet e punonjësve	18
16 Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	19
17 Të ardhura financiare	19
18 Shpenzime financiare	19
19 Tatimi mbi fitimin	19
20 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	20
21 Ngjarjet mbas datës së raportimit	20
22 Palët e lidhura	20



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Pronarëve të
DDB Albania Sh.a

Tiranë, 30 mars 2012

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale bashkëngjitur të DDB Albania Sh.a ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra individuale e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2011, pasqyrat individuale të të ardhurave përmbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare individuale në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare individuale bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare individuale nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare individuale. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare individuale në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare individuale.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare individuale të Shoqërisë më 31 dhjetor 2011, të rezultatit të saj financiar individual dhe të flukseve të saj të monetare individuale për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Shpk

KPMG Albania Sh.p.k.
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

DDB Albania Sh.A.

Pasqyra individuale e pozicionit financiar

(Vlerat në Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
Aktive			
Aktive jo materiale	6	831,677	978,440
Aktive afatgjata materiale	7	12,929,160	11,270,255
Investime në filiale	8	1,340,000	1,340,000
Totali i aktiveve afatgjata		15,100,837	13,588,695
Kërkesa për arkëtim nga debitorët	9	33,233,739	16,862,148
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	22	1,766,503	2,129,564
Tatim fitim i parapaguar		119,533	466,384
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	10	32,330,988	13,621,963
Totali i aktiveve afatshkurtra		67,450,763	33,080,059
Totali i aktiveve		82,551,600	46,668,754
Kapitalet e veta			
Kapitali themeltar	11	2,000,000	2,000,000
Rezerva ligjore		200,000	200,000
Fitime të ushtrimit dhe të mbartura		18,456,904	10,555,473
Totali i kapitaleve të veta		20,656,904	12,755,473
Detyrime			
Hua afatshkurtër		6,807,374	-
Furnitorë dhe detyrime të tjera	12	46,651,513	29,493,172
Detyrime ndaj palëve të lidhura	22	8,435,809	4,420,109
Totali i detyrimeve		61,894,696	33,913,281
Totali i detyrimeve dhe kapitaleve të veta		82,551,600	46,668,754

Pasqyra individuale e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesë përbërëse të pasqyrave financiare individuale në faqet 5 deri 21.

DDB Albania Sh.A.

Pasqyra individuale e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor

(Vlerat në Lek)

	Shënime	2011	2010
Të ardhurat	13	239,087,023	125,557,325
Kosto për kryerjen e shërbimeve	14	(176,776,574)	(79,065,359)
Fitimi bruto		62,310,449	46,491,966
Shpenzime lidhur me përfitimet e punonjësve	15	(36,396,360)	(28,467,814)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	16	(14,234,213)	(10,273,124)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	6,7	(2,837,476)	(1,872,622)
Fitimi nga veprimtaritë shfrytëzuese		8,842,400	5,878,406
Të ardhura financiare	17	1,464,933	984,560
Shpenzime financiare	18	(1,521,735)	(582,449)
(Shpenzime)/të ardhura financiare, neto		(56,802)	402,111
Fitimi para tatimit		8,785,598	6,280,517
Tatimi mbi fitimin	19	(884,167)	(583,622)
Fitimi neto për vitin		7,901,431	5,696,895
Të ardhura të tjera përmbledhëse		-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin		7,901,431	5,696,895

Pasqyra individuale e të ardhurave përmbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesë përbërëse të pasqyrave financiare individuale në faqet 5 deri 21.

DDB Albania Sh.A.

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

(Vlerat në Lek)

	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 1 Janar 2010	2,000,000	200,000	14,858,578	17,058,578
Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën	-	-	5,696,895	5,696,895
Fitimi i vitit	-	-	5,696,895	5,696,895
Kontribute nga pronarët dhe shpërndarje pronarëve	-	-	(10,000,000)	(10,000,000)
Dividendë të paguar	-	-	(10,000,000)	(10,000,000)
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	2,000,000	200,000	10,555,473	12,755,473
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	-	7,901,431	7,901,431
Fitimi i vitit	-	-	7,901,431	7,901,431
Kontribute nga pronarët dhe shpërndarje pronarëve	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	2,000,000	200,000	18,456,904	20,656,904

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesë përbërëse të pasqyrave financiare individuale në faqet 5 deri 21.

DDB Albania Sh.A.


Pasqyra individuale e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor


(Vlerat në Lek)

	Shënime	2011	2010
Flukse monetare nga veprimtari shfrytëzuese			
Fitimi neto i vitit		7,901,431	5,696,895
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	6,7	2,837,476	1,872,622
Tatimi mbi fitimin		884,167	583,622
Fitimi nga veprimtaritë shfrytëzuese para ndryshimeve në kapitalin punues		11,623,074	8,153,139
Rritja e kërkesave për arkëtim		(69,986,725)	(1,132,837)
Rritja e llogarive të pagueshme		74,913,170	16,125,585
Tatimi mbi fitimin i paguar		(298,250)	(1,154,788)
Mjete monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		16,251,269	21,991,099
Flukse monetare nga veprimtaritë investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	6,7	(4,349,618)	(7,444,702)
Shitje pjesore e investimit në filial	8	-	660,000
Mjete monetare përdorur në veprimtaritë investuese		(4,349,618)	(6,784,702)
Flukse monetare nga veprimtaritë financuese			
Të arkëtuara nga përdorimi i kredisë kufi		6,807,374	-
Dividendë të paguar	11	-	(10,000,000)
Mjete monetare nga/(përdorur në) veprimtaritë financuese		6,807,374	(10,000,000)
Rritja neto e mjeteve monetare		18,709,025	5,206,397
Mjete monetare në fillim të vitit	10	13,621,963	8,415,566
Mjete monetare në fund të vitit	10	32,330,988	13,621,963

Pasqyra individuale e flukseve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese dhe pjesë përbërëse të pasqyrave financiare individuale në faqet 5 deri 21.

Këto pasqyra financiare individuale u aprovuan dhe nënshkruan nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë më 30 Mars 2012:


Julia Isaj
Drejtor i Përgjithshëm



DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

1 Informacion i përgjithshëm

DDB Albania Sh.A. ("Shoqëria") ofron shërbime reklamash për klientë në Shqipëri dhe në tregun e huaj. Burimet e të ardhurave për Shoqërinë janë si më poshtë:

- Shërbimet e medias për shoqëritë mbi bazën e komisioneve;
- Prodhimi i reklamave për klientë – e ardhura përcaktohet si përqindje mbi koston totale të prodhimit;
- Shërbime të tjera, (fushata, plane media, zhvillime në fushën e reklamave) për të cilat çmimi është i përcaktuar;
- Shërbime të ofruara me një komision fiks mujor.

Shoqëria është filial i Olympic DDB Holdings Cyprus Limited, e cila zotëron 60% të kapitalit aksionar, dhe rrjedhimisht filial i Omnicom Group Inc. Pjesa tjetër e kapitalit aksionar zotërohet prej Ardian Garo (21%), Pandeli Garo (14%) dhe Admir Banaj (5%).

Me vendim të bordit të mbikqyrës datë 26 Janar 2011, duke filluar që nga 1 Shkurti 2011 Znj. Juela Isaj u caktua Drejtor i Përgjithshëm në vënd të Z. Ardian Garo.

Selia e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në Rruga e Dibres, Observator Business Center, Kati 12, dhe më 31 Dhjetor 2011 ajo punësonte 18 punonjës (2010: 18 punonjës).

2 Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Konsolidimi

Shoqëria zotëron 67% të aksioneve të Optimum Media Sh.A (2010: 67%). Investimi në filial përfshihet në Shënimin 8 – Investime në filiale. Shoqëria ka zgjedhur të mos paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara, duke aplikuar përjashtimin nga paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara të sic përcaktohet në SNK 27.10 si më poshtë:

- Shoqëria është në vetvete një filial i Omnicom Group Inc., dhe pronarët e tjerë të saj janë të informuar, dhe nuk kanë kundërshtime që Shoqëria të mos paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara;
- Instrumentat e borxhit dhe të kapitalit të Shoqërisë nuk tregtohen në një treg publik;
- Shoqëria mëmë përfundimtare (Omnicom Group Inc.) dhe ajo e ndërmjetme (Olympic DDB Holdings Cyprus Limited) e Shoqërisë përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim nga publiku, të cilat janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Për qëllimin e paraqitjes së pasqyrave financiare të ndara, investimet në filiale janë matur me kosto.

(c) Baza e matjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur bazuar në koston historike.

(d) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare individuale janë të paraqitura në Lek, e cila është monedha funksionale për Shoqërinë.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

2 Baza e përgatitjes (vazhdim)

(e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacion mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare individuale jepet në Shënimin 5 Menaxhimi i riskut financiar.

3 Përmbledhje e politikave kontabël

(a) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi (shih politikën kontabël 3(d)).

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme për qëllime të përdorimit dhe kosto të kapitalizuara të huamarrjes.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësitë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja nga shitja e një aktivi afatgjatë material përcaktohet duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël të aktivitetit afatgjatë material, dhe njihet neto në të ardhura/shpenzime të tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën e zvogëlimit të tepricës. Metodot e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) janë rivlerësuar në datën e raportimit.

Më poshtë janë normat e amortizimit të aplikuara:

- | | |
|--|-----|
| • Pajisje informatike | 25% |
| • Automjete | 20% |
| • Pajisje zyre | 20% |
| • Të tjera (pajisje) | 20% |
| • Të tjera (përmirësime të ambjenteve me qera) | 5% |

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(b) Aktive jo materiale

Aktivet jo-materiale përbëhen nga programet kompjuterike të blera nga Shoqëria, të cilat njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi (shih politikën kontabël 3(d)). Amortizimi njihet në fitim ose humbje bazuar në metodën e zvogëlimit të tepicës. Përdoret norma e amortizimit prej 15%.

(c) Instrumentet financiarë

Shoqëria mban vetëm instrumente financiarë jo-derivativë.

(i) *Aktive financiare jo-derivative*

Shoqëria njih fillimisht llogaritë e arkëtueshme në datën kur ato lindin. Të gjithë aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e transaksionit, e cila është data kur Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria nuk e njih më një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur transferon të drejtat e hyrjeve monetare kontraktuale te aktivitet financiar, në një transaksion ku të gjitha risqet dhe përfitimet nga pronesia e aktivitet financiar janë transferuar. Interesi i aktiveve financiare të transferuara që është krijuar ose mbajur nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim i vecantë.

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore të netojë vlerat dhe ka për qëllim të shlyhet në bazë neto ose të arkëtojë aktivin dhe paguajë detyrimin njëkohësisht.

Aktivet financiarë jo-derivativë përfshijnë mjete monetare dhe ekuivalente me to, dhe të arkëtueshme nga klientë e të tjerë.

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogari rrjedhëse në banka me maturitet origjinal tre muaj ose më pak dhe mbahen me koston e amortizuar.

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre dhe në vijim maten me kosto të amortizuar pakësuar për humbjet nga zhvlerësime.

(ii) *Detyrime financiare jo-derivative*

Detyrimet financiare njihen fillimisht në datën e transaksionit, e cila është data kur Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria nuk e njih më një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale të Shoqërisë janë shlyer, janë anuluar ose maturuar.

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore të netojë vlerat dhe ka për qëllim të shlyhet në bazë neto ose të arkëtojë aktivin dhe paguajë detyrimin njëkohësisht.

Shoqëria klasifikon detyrimet financiare jo-derivative në kategorinë e detyrimeve të tjera financiare, e cila përbëhet nga huamarrjet, detyrimet tregtare dhe të tjera dhe detyrimet ndaj palëve të lidhura. Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre, dhe në vijim maten me kosto të amortizuar.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(c) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(iii) *Kapitali aksioner*

Kapitali aksioner i Shoqërisë është njohur me vlerë nominale.

(d) *Zhvlerësimi*

(i) *Aktivet financiare jo-derivative*

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar është zhvlerësuar nëse evidencë objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim negativ në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të debitorëve, ristrukturimin e një shume me kushte dhe afate të cilat Shoqëria nuk do t'i kishte dhënë ndryshe, të dhëna që një debitor po falimenton ose ndryshime të pafavorshme në aftësitë paguese të huamarrësve të Shoqërisë.

Shoqëria konsideron evidencën e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme të cilat janë individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të rëndësishme që rezultojnë të mos jenë individualisht të zhvlerësuara vlerësohen më pas në mënyrë kolektive për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur por nuk është identifikuar ende. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen në mënyrë kolektive duke grupuar së bashku llogaritë e arkëtueshme që kanë karakteristika të ngjashme rreziku.

Për vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor modele statistikore të përvojës historike të humbjes, periudhën e rimarrjes dhe vlerën e humbjes, duke përfshirë dhe gjykimin e drejtuesve nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditimit janë të tilla që humbjet aktuale të ketë gjasa të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimi historik.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuara skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt llogarive të arkëtueshme. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen. Kur një ngjarje pas datës së raportimit (p.sh. pagesa nga një debitor) tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zvogëlimi i zhvlerësimit anulohet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(ii) *Aktivet jo-financiare*

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(d) Zhvlerësimi (vazhdim)

(ii) *Aktivet jo-financiare* (vazhdim)

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është me e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe çmimit neto të shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin ose njësinë gjeneruese të mjeteve monetare. Për qëllime të testimit të zhvlerësimit, aktivet që nuk mund të testohen individualisht, grupohen së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm që janë të pavarur nga flukset hyrëse të aktiveve apo njësisive të tjera gjeneruese.

Përsa i përket aktiveve të tjera, humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme, rivlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse humbjet janë zvogëluar ose eliminuar. Një humbje për zhvlerësim anulohet nëse ka ndryshim në vlerësimin e përdorur për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(e) Njohja e të ardhurave

E ardhura nga kryerja e shërbimeve njihet në fitim ose humbje kur shërbimi kryhet.

(f) Përfitimet e punonjësve

Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në shpenzime kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës së mbyllur.

(g) Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

Shpenzimet e qirasë

Shpenzimet e qirasë së zakonshme janë ngarkuar në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë periudhës së qirasë. Pagesa motivimi marrë nga qiradhënësi janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë përgjatë periudhës së qirasë.

(h) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga llogaritë në banka dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në fitim ose humbje. Të ardhurat nga interesi njihen kur ai përfitohet duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Të gjitha kostot e huave njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efekt.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Tatim fitimi

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përbëhet nga tatimi aktual dhe i shtyrë. Tatimi aktual dhe i shyrë njihet në fitim dhe humbje deri në masën që lidhet me zërat që njihen direkt në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin ose humbjen e tatueshme të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e raportimit.

Aktivet dhe pasivet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet për tatimin aktual të pagueshëm ndaj tatimit të parapaguar, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimpagues.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Për të përcaktuar shumat e tatim fitimit aktual dhe të shtyrë, Shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicionit fiskal të pasigurtë dhe nëse taksa e penalitete të tjera mund të jenë të pagueshme. Shoqëria beson se shpenzimet e përlllogaritura për detyrimet fiskale janë të përshtatshme për të gjitha vitet fiskale bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, përfshirë interpretimet e ligjit tatimor dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë shumë gjykime për ngjarje të ardhshme. Informacion i ri i disponueshëm mund të sjellë ndryshimin e gjykimit të Shoqërisë përsa i përket përshtatshmërisë së detyrimeve fiskale ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet fiskale do të ndikojnë shpenzimin fiskal të periudhës në të cilën është bërë ky përcaktim.

(j) Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës.

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Aktivet dhe detyrimet jo-materiale në monedhë të huaj që maten me kosto historike konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka).

(k) Standarte dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për fundin e vitit 31 Dhjetor 2011, dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare individuale. Asnjë prej tyre nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

4 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare është përafërsisht e barabartë me vlerën kontabël për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër.

5 Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare individuale.

Struktura e menaxhimit të riskut

Bordi i Drejtorëve mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për menaxhimin e riskut.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në banka, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

Paqëndrueshmëria në tregun financiar ndërkombëtar dhe shqiptar

Kriza aktuale financiare dhe ekonomike ka rezultuar, ndërmjet të tjerave, në një nivel më të ulët të financimit të tregut të kapitalit, nivele më të ulta likuiditeti përmes sektorit bankar, dhe ndonjëherë, në interesa huadhënie ndërbankare më të larta dhe paqëndrueshmëri në tregjet e aksioneve. Pasiguritë në tregjet financiare ndërkombëtare kanë çuar gjithashtu në falimentime bankash dhe shpëtimin e tyre kudo në botë. Shtrirja e plotë e ndikimit të krizës financiare aktuale tregon se është e pamundur të parashikohet apo të mbrohet plotësisht prej saj.

Ndikimi në likuiditet

Volumi i financimit nga shitësit e shumicës ka rënë ndjeshëm kohët e fundit. Rrethana të tilla mund të ndikojnë mundësinë e Shoqërisë për të marrë hua të reja, nëse do të jetë e nevojshme, dhe të ri-financojë huatë ekzistuese me kushte dhe afate të ngjashme me ato të aplikuara më parë.

Ndikimi në klientët/huamarrësit

Debitorët e Shoqërisë mund të ndikohen nga situata e likuiditetit të ulët i cili mund të ndikojë aftësinë e tyre për ripagimin e shumave që detyrohen. Përkeqësimet e kushteve shfrytëzuese për klientët mund të ndikojnë gjithashtu parashikimet e fluseve monetare nga drejtimi dhe vlerësimin e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe jo-financiare. Deri në atë masë që informacioni është i disponueshëm, drejtimi ka reflektuar siç duhet vlerësime të korigjuara të flukseve monetare të pritshme në vlerësimet e zhvlerësimit.

DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

5 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(i) Risku i kredisë

Risku i mos-pagesës ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet për pagesën e llogarive të arkëtueshme.

Maksimumi i riskut të kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Risku i kredisë i cili është identifikuar merret parasysh nëpërmjet zhvlerësimeve. Shoqëria e vlerëson cilësinë e llogarive të arkëtueshme që nuk janë me vonesë dhe as të zhvlerësuara si të kënaqshme.

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal ndaj riskut të kredisë. Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë në ditën e raportimit ishte:

	31 Dhjetor	
	2011	2010
Kërkesa tregtare për arkëtim (shiko shënimin 9)	32,757,402	16,725,471
Të tjera kërkesa të arkëtueshme (shiko shënimin 9)	476,337	136,677
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura (shiko shënimin 22)	1,766,503	2,129,564
Mjete monetare dhe ekuivalente me to (shiko shënimin 10)	32,330,988	13,621,963
	67,331,230	32,613,675

Humbje nga zhvlerësimi

Analiza sipas vjetërsisë e kërkesave tregtare për arkëtim në datën e raportimit është:

	31 Dhjetor	
	2011	2010
Të pa vonuara	19,726,424	13,034,927
Më shumë se 30 dhe më pak se 60 ditë	2,056,427	1,192,753
Më shumë se 60 dhe më pak se 90 ditë	8,845,573	525,080
Më shumë se 90 dhe më pak se 120 ditë	-	314,520
Më shumë se 120 dhe më pak se 360 ditë	-	1,562,870
Më shumë se 360 ditë	2,128,978	95,321
Vlera bruto	32,757,402	16,725,471
Fondi për zhvlerësim	-	-
Gjendja në fund të vitit	32,757,402	16,725,471

Bazuar në historikun e normës së mospagimit, Shoqëria beson se nuk është i nevojshëm ndonjë provizion për zhvlerësim në lidhje me kërkesat tregtare për arkëtim të cilat janë të vonuara.

(ii) Risku i likuiditetit

Shoqëria duhet të përmbushë nevojat për mjete monetare, kryesisht për kostot e shfrytëzimit që rrjedhin nga aktivitetet e publicitetit. Ekziston rreziku që mjetet monetare mund të mos jenë të disponueshme për të shlyer detyrimet në kohën e duhur me një kosto të arsyeshme. Shoqëria monitoron likuiditetin në baza periodike në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur ato kërkohen.

Më poshtë paraqiten aktivitetet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit të mbetur më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010:

DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

5 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(ii) Risku i likuiditetit (vazhdim)

	31 Dhjetor 2011				Totali
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vite	Mbi 5 vite	
Kërkesa për arkëtim nga klientët	32,757,402				32,757,402
Të tjera të arkëtueshme	476,337				476,337
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	1,766,503	-	-	-	1,766,503
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	32,330,988	-	-	-	32,330,988
	67,331,230				67,331,230
Hua afatshkurtra	(6,807,374)	-	-	-	(6,807,374)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(8,435,809)	-	-	-	(8,435,809)
Furnitorë dhe detyrime të tjera	(46,651,513)	-	-	-	(46,651,513)
	(61,894,696)				(61,894,696)
Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2011	5,436,534				5,436,534

	31 Dhjetor 2010				Totali
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vite	Mbi 5 vite	
Kërkesa për arkëtim nga klientët	16,725,471	-	-	-	16,725,471
Të tjera të arkëtueshme	136,677				136,677
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	2,129,564	-	-	-	2,129,564
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	13,621,963	-	-	-	13,621,963
	32,613,675				32,613,675
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(4,420,109)	-	-	-	(4,420,109)
Furnitorë dhe detyrime të tjera	(29,493,172)	-	-	-	(29,493,172)
	(33,913,281)				(33,913,281)
Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2010	(1,299,606)				(1,299,606)

DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

5 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(iii) Risku i tregut

Risku i normave të interesit

Në 31 Dhjetor 2011 Shoqëria kishte një risk nga flukset e mjeteve monetare të lidhur me kredinë kufi e cila ishte me normë interesi te ndryshueshme. Drejtimi nuk ka hyrë në transaksione derivative për tu mbrojtur nga ky risk.

Një ndryshim me 100 pikë bazë në normën e interesit më 31 Dhjetor 2011 do të rriste ose zvogëlonte kapitalin dhe fitim ose humbjen me 68,074 Lek.

Shoqëria nuk kishte instrumenta financiarë me interes më 31 Dhjetor 2010.

Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria ndërmerr transaksione në Lek, Euro dhe USD. Ekspozimi më i madh ne monedhë të huaj lidhet me aktivet dhe pasivet në Euro. Risku i pozicionit valutor menaxhohet nëpërmjet parimit të përputhjes së aktiveve me detyrimet. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontrata të ardhshme shkëmbimi më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010.

Ekspozimi Shoqërisë ndaj riskut të pozicionit valutor në 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 ishte si më poshtë:

	31 Dhjetor 2011			
	EUR	USD	LEK	Total
Kërkesa për arkëtim nga klientët	2,326,900		30,430,502	32,757,402
Të tjera të arkëtueshme	-	-	476,337	476,337
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	1,766,503	-	-	1,766,503
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	5,625,315	102	26,705,571	32,330,988
	9,718,718	102	57,612,410	67,331,230
Hua afatshkurtra	(6,807,374)	-	-	(6,807,374)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(598,419)	-	(7,837,390)	(8,435,809)
Furnitorë dhe detyrime të tjera	(20,183,849)	-	(26,467,664)	(46,651,513)
	(27,589,642)	-	(34,305,054)	(61,894,696)
Risku i pozicionit valutor më 31 Dhjetor 2011	(17,870,924)	102	23,307,356	5,436,534

	31 Dhjetor 2010			
	EUR	USD	LEK	Totali
Kërkesa për arkëtim nga klientët	4,485,244	-	12,240,227	16,725,471
Të tjera të arkëtueshme	-	-	136,677	136,677
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	1,248,930	-	880,634	2,129,564
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	2,549,360	101	11,072,502	13,621,963
	8,283,534	101	24,330,040	32,613,675
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(434,023)	-	(3,986,086)	(4,420,109)
Furnitorë dhe detyrime të tjera	(11,999,230)	-	(17,493,942)	(29,493,172)
	(12,433,253)	-	(21,480,028)	(33,913,281)
Risku i pozicionit valutor më 31 Dhjetor 2010	(4,149,719)	101	2,850,012	(1,299,606)

DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

5 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(iii) Risku i tregut (vazhdim)

Risku i kursit të këmbimit (vazhdim)

Kursi i këmbimit për Lekun në fund të çdo periudhe raportimi ishte si më poshtë:

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
1 USD	107.54	104.00
1 EUR	138.93	138.77

Një forcim apo dobësim i Lek-ut me 10% kundrejt Euro-s më 31 Dhjetor 2011 do të rriste ose zvogëlonte kapitalin dhe fitim-humbjen me 1,787,092 Lek (2010: rriste ose zvogëlonte me 414,972 Lek).

(iv) Menaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Bordi i Drejtorëve monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura neto të shfrytëzimit ndaj totalit të kapitalit.

Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.

6 Aktive afatgjata jo-materiale

	Programe kompjuterike
Kosto	
Më 1 Janar 2010	-
Shtesa	1,087,155
Më 31 Dhjetor 2010	1,087,155
Shtesa	-
Më 31 Dhjetor 2011	1,087,155
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 Janar 2010	-
Amortizimi për vitin	(108,715)
Më 31 Dhjetor 2010	(108,715)
Amortizimi për vitin	(146,763)
Më 31 Dhjetor 2011	(255,478)
Vlera kontabel neto	
Më 1 Janar 2010	-
Më 31 Dhjetor 2010	978,440
Më 31 Dhjetor 2011	831,677

DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

7 Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale përbëhen nga sa më poshtë:

	Paisje informatike	Paisje zyre	Të tjera	Automjete	Totali
Kosto					
Më 1 Janar 2010	3,323,396	737,784	904,943	5,239,860	10,205,983
Shtesa	414,604	1,238,051	1,232,770	3,472,122	6,357,547
Më 31 Dhjetor 2010	3,738,000	1,975,835	2,137,713	8,711,982	16,563,530
Shtesa	1,745,415	408,405	308,292	1,887,506	4,349,618
Më 31 Dhjetor 2011	5,483,415	2,384,240	2,446,005	10,599,488	20,913,148
Amortizimi i akumuluar					
Më 1 Janar 2010	(2,083,752)	(510,351)	(488,101)	(447,164)	(3,529,368)
Amortizimi për vitin	(375,411)	(147,534)	(108,817)	(1,132,145)	(1,763,907)
Më 31 Dhjetor 2010	(2,459,163)	(657,885)	(596,918)	(1,579,309)	(5,293,275)
Amortizimi për vitin	(441,260)	(314,555)	(193,779)	(1,741,119)	(2,690,713)
Më 31 Dhjetor 2011	(2,900,423)	(972,440)	(790,697)	(3,320,428)	(7,983,988)
Vlera kontabel neto					
Më 1 Janar 2010	1,239,644	227,433	416,842	4,792,696	6,676,615
Më 31 Dhjetor 2010	1,278,837	1,317,950	1,540,795	7,132,673	11,270,255
Më 31 Dhjetor 2011	2,582,992	1,411,800	1,655,308	7,279,060	12,929,160

Aktive të tjera afatgjata materiale përfshijnë përmirësimet e ambjenteve me qera me vlerë kontabel neto prej 937,424 Lek (2010: 986,761 Lek) dhe pajisje të studios me vlerë kontabel neto prej 717,884 Lek (2010: 554,034 Lek).

8 Investime në filiale

Më 3 Dhjetor 2007, Asambleja e Përgjithshme e pronarëve të DDB Albania Sh.a aprovoi themelimin e "Optimum Media" Sh.a, e cila ofron shërbime reklame dhe shërbime të tjera të ngjashme. Kjo Shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në 28 Shkurt 2008.

Fillimisht DDB Albania ishte e vetmja pronare e këtij filiali. Kapitali aksionar i Optimum Media Sh.a është 2 milion Lek, i përbërë nga 2,000 aksione me vlerë nominale 1,000 Lek secili. Gjatë vitit 2010, 660 aksione iu transferuan me vlerë nominale Znj. Vilma Maze dhe më 31 Dhjetor 2011 DDB Albania kishte një pjesëmarrje prej 67 % (2010: 67%) dhe Znj. Vilma Maze 33% (2010: 33%).

DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

9 Kërkesa për arkëtim nga nga debitorët

Kërkesa për arkëtim përbëhen nga sa më poshtë:

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
Kërkesa tregtare për arkëtim	32,757,402	16,725,471
Parapagime furnitorëve	129,012	124,198
Të tjera të arkëtueshme	347,325	12,479
Totali	33,233,739	16,862,148

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kredisë dhe pozicionit valutor si dhe humbjet nga zhvlerësimi lidhur me kërkesat për arkëtim janë të paraqitura në shënimin 5.

10 Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përbëhen nga sa më poshtë:

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
Vlera në arkë	974,051	44,641
Vlera në banka		
Në Lek	26,242,394	11,071,184
Në Euro	5,114,543	2,506,138
Totali	32,330,988	13,621,963

Alpha Bank Albania ka lëshuar një Letër Garancie për Shoqërine në shumën 70,000 Euro (ekuivalent 9,725,100 Lek), e cila është e garantuar nga Olympic DDB Holding Cyprus Limited (shih shënimin 22)

11 Kapitali themeltar

Kapitali i paguar është 2,000,000 Lek i përbërë nga 2,000 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1,000 Lek secili. Kapitali aksionar i nënshkruar është paguar plotësisht.

Bazuar në vendimin e asamblesë së aksionarëve të datës 30 Qershor 2010, asambleja deklaroi dividendët lidhur me rezultatin financiar të vitit 2009. Dividendi i shpërndarë në vitin 2010 ishte 10,000,000 Lek dhe u shpërnda në mënyrë proporcionale me strukturën e pronësisë aksionere.

12 Furnitorë dhe detyrime të tjera

Furnitorë dhe detyrime të tjera përbëhen nga sa më poshtë:

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
Furnitorë	39,834,203	22,252,684
TVSH e pagueshme, neto	4,149,213	2,442,862
Paga të pagueshme	893,745	458,891
Taksa dhe tatime të tjera	776,808	692,535
Detyrime të tjera	997,544	3,646,200
Totali	46,651,513	29,493,172

DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

13 Të ardhurat

Të ardhurat sipas aktivitetit përbëhen nga sa më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010
Media	11,828,667	9,905,522
Prodhim	141,496,616	70,844,828
Dizajn	15,781,365	13,645,707
Reklama	3,342,260	1,076,400
Komision fiks	10,299,205	12,695,523
Të ardhura nga auto-faturimi (shënimi 14)	56,184,034	17,389,345
Të tjera	154,876	-
Totali	239,087,023	125,557,325

14 Kosto për kryerjen e shërbimeve

Kosto për kryerjen e shërbimeve sipas aktivitetit përbëhen nga sa më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010
Media	10,839,834	7,419,709
Prodhim	109,752,706	54,256,305
Shpenzime auto-faturimi	56,184,034	17,389,345
Totali	176,776,574	79,065,359

Shpenzime auto-faturimi janë në lidhje me mekanizmin e “Auto-fatirimit” të aplikuar nga Shoqëria për qëllime të raportimit të TVSH në lidhje me shërbime të ofruara nga entitete jo-rezidente (p.sh. që nuk janë regjistruar për qëllime të TVSH në Shqipëri). Të ardhura nga auto-faturimi janë njohur si një kundërlllogari e këtyre shpenzimeve (shënimi 13).

15 Shpenzime lidhur me përfitimet e punonjësve

Shpenzimet lidhur me përfitimet e punonjësve janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010
Paga dhe shpërblime	33,867,613	26,399,972
Sigurime shoqërore	2,528,747	2,067,842
Totali	36,396,360	28,467,814

DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

16 Shpenzime të përgjithshme dhe administrative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative janë të analizuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010
Qera	3,528,108	3,255,510
Postare dhe komunikimi	2,346,747	1,602,826
Udhëtime dhe dieta	1,223,976	564,505
Taksa të tjera	55,736	87,480
Auditim dhe konsulencë	2,041,327	1,593,128
Shpenzime zyre	1,893,683	1,624,698
Shpenzime të tjera operative	3,144,636	1,544,977
Totali	14,234,213	10,273,124

17 Të ardhura financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga sa më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010
Dividend nga investimi në filial	885,869	659,548
Fitime nga këmbimi	575,752	320,112
Të ardhura interesi	3,312	4,900
Totali	1,464,933	984,560

18 Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010
Shpenzime për interesa	177,938	-
Humbje nga këmbimi	545,647	275,468
Komisione bankare	798,150	306,981
Totali	1,521,735	582,449

19 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi aktual prej 884,167 Lek (2010: 583,622 Lek). Tatimi mbi fitimin në Shqipëri vlerësohet në normën 10% të fitimit të tatueshëm (2010: 10%). Më poshtë paraqitet një rakordim i tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e taksës së aplikueshme me shpenzimin e tatimit mbi fitimin:

	Norma efektive e tatimit	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011	Norma efektive e tatimit	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010
Fitimi para tatimit		8,785,598		6,280,517
Tatimi fillestar	10%	878,560	10%	628,052
Shpenzime te pa-zbritshme	1.1%	94,194	0.3%	21,524
E ardhur dividendi e zbritshme	(1%)	(88,587)	(1%)	(65,954)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	10.1%	884,167	9.3%	583,622

DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

20 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Angazhime për qiranë e zakonshme

Më 31 Dhjetor 2011 Shoqëria ishte palë në një marrëveshje qiraje të zakonshme për zyrat e cila mbaron më 30 Qershor 2013. Pagesat e ardhme minimale brenda një viti janë 3,484,364 Lek (2010: 3,480,352 Lek) dhe midis një dhe pesë vjet janë 1,742,182 Lek (2010: 5,220,527 Lek).

21 Ngjarjet mbas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare individuale.

22 Palët e lidhura

Palët janë të konsideruara të lidhura kur një nga palët ka aftësinë për të kontrolluar ose të ushtrojë influencë të mjaftueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë.

Palët e lidhura përfshijnë Olympic DDB Holdings Cyprus Limited i cili zotëron 60% të kapitalit aksionar të Shoqërisë, dhe grupin e kompanive të Omnicom Group Inc dhe Optimum Media Sh.a si filial i Shoqërisë. Drejtimi i Shoqërisë përfshin Bordin e Drejtorëve dhe Drejtorin e Përgjithshëm.

Një numër transaksionesh janë zhvilluar me palët e lidhura në ecurine normale të biznesit. Volumi i këtyre transaksioneve dhe vlerat e mbartura në fund të periudhave raportuese janë si më poshtë:

DDB Albania Sh.A

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale

(Vlerat në Lek)

22 Palët e lidhura (vazhdim)	31 Dhjetor	
	2011	2010
Kërkesa të tjera për arkëtim nga Optimum Media Sh.A	814,479	880,634
Divident i arkëtueshem nga Optimum Media Sh.A	952,024	-
Kërkesa të tjera për arkëtim nga Olympic DDB S.A	-	1,248,930
Totali i kërkesave për arkëtim nga palët e lidhura	1,766,503	2,129,564
Të pagueshme ndaj Olympic DDB Holding	251,094	87,098
Të pagueshme ndaj Optimum Media	7,837,390	3,986,086
Të pagueshme ndaj DDB Sofia OOD	347,325	346,925
Totali i detyrimeve ndaj palëve të lidhura	8,435,809	4,420,109
Shpenzime të përgjithshme të faturuara nga Olympic DDB S.A.	179,243	87,550
Shpenzime të përgjithshme të faturuara nga DDB Sofia OOD	-	3,307,685
Shpenzime të përgjithshme të faturuara nga Optimum Media Sh.A	10,756,536	4,988,405
Totali i shpenzimeve të përgjithshme të faturuara nga palët e lidhura	10,935,779	8,383,640
Shpenzime të faturuara ndaj Olympic DDB S.A.	-	2,063,700
Shpenzime të faturuara ndaj Optimum Media Sh.A	-	1,228,356
Shpenzime të faturuara ndaj Omnicom Financial Services Ltd	154,879	-
Total i shpenzimeve të faturuara ndaj palëve të lidhura	154,879	3,292,056
Dividend paguar ndaj Olympic DDB Holding Cyprus	-	6,000,000
Dividend paguar ndaj Olympic DDB S.A	-	-
Dividend paguar ndaj Ardian Garo (2010: Drejtor i Përgjithshëm)	-	2,100,000
Dividend paguar ndaj Pandeli Garo (2010: i lidhur me Drejtorin e Përgjithshëm)	-	1,400,000
Dividendë paguar palëve të lidhura		9,500,000
Shpenzime për përfitimet e drejtuesve	9,462,629	6,063,163

Më 31 Dhjetor 2011, Olympic DDB Holding Cyprus Limited ka lëshuar një garanci korporate në favor të Alpha Bank Albania për një Letër Garancie që kjo e fundit i ka lëshuar Shoqërisë (shënimi 10).